



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 200, Datë 15.08.2025

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “SOLAR HORIZON” SH.P.K. PËR DHËNIEN E
AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE SI MJET PËR
GARANTIMIN E PËRMBUSHJES SË DETYRIMIT NDAJ “PROCREDIT BANK”
SH.A.**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 3 dhe 8 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie autorizimit nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE) për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.08.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2158/3 prot., datë 12.08.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë “SOLAR HORIZON” sh.p.k për dhënie autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “ProCredit Bank” sh.a.”,

Konstatoi se,

- Shoqëria “SOLAR HORIZON” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 94, datë 28.04.2025.
- Me shkresën nr. 2158 prot., datë 24.07.2025, shoqëria ka paraqitur kërkesën/dokumentacionin për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet (barrë siguruese) për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “ProCredit Bank” sh.a.
- Në kuadër të kësaj kërkeje dhe në mbështetje të dispozitave të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021, shoqëria ka depozituar, ndër të tjera: Kontratat e Kredisë Bankare dhe Kontratë Pengu (Kontratë Pengu Kuota të shoqërisë), ku citohet vendosja e pengut të radhës së parë të 100% të kuotave të kredimarrësit.

- Konstatohet se si kontratat e kredisë ashtu edhe ajo e pengut rezultojnë të nënshkruara përpara se shoqëria të ishte licencuar nga ERE, ***pra përpara se shoqërisë t'i lindte detyrimi për të marrë autorizimin e ERE-s për këtë barrësim.***
- ERE me shkresën nr. 2158/1 prot., datë 01.08.2025 i ka kërkuar shoqërisë të informojë nëse është nënshkruar ndonjë marrëveshje siguruese vijuese apo ka patur rishikim të asaj ekzistuese me bankën pas licencimit në lidhje me barrësimin e kuotave.
- Në përgjigje me shkresën nr. 2158/2 prot., datë 06.08.2025, shoqëria bëri me dije se nga data e licencimit e deri më sot, nuk janë lidhur kontrata të tjera kredie apo garancie me “ProCredit Bank” sh.a. apo institucione të tjera bankare/financiare. Gjithashtu informon se pritët ndërmarrja e hapave të tjerë tekniko-administrativë për operimin e centralit, paketa e garancive të tjera përveç pengut mbi kuotat, të cilat nuk janë formalizuar ende, ndaj citon se do të vazhdojë të informojë ERE-n për çdo zhvillim të mëtejshëm në lidhje me marrëdhënien me këtë bankë si dhe hapat që do marrë në lidhje me ecurinë e projektit. *Ndaj ERE në vijim të vendimmarrjes së bordit, do të njoftojë shoqërinë se në çdo rast të lënies peng të aseteve të centralit, shoqëria përveç informimit duhet të përcjellë aplikimin si dhe dokumentacionin/informacionin përkatës, siç kërkuar në kuptim të nenit 7 të rregullores nr. 119/2016 “Rregullore e transferimit të aseteve nga të licencuarit”.*
- Si e tillë, vlerësohet se ERE nuk mund të marrë në shqyrtim kërkesën e shoqërisë për sa kohë marrëdhënia juridike me bankën për vendosje barre siguruese është krijuar përpara se shoqëria të merrte statusin e të licencuarit dhe të lindnin detyrimet përkatëse në kuadër të këtij statusi.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të mos marrë në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “SOLAR HORIZON” sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të kapitalit si mjet për garantimin e detyrimeve ndaj “ProCredit Bank” sh.a.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “SOLAR HORIZON” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI